



## MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

në mes të

### **Komunës së Gjakovës**

(më tej "Komuna")

Përfaqësuar nga: **Z. Ardian Gjini - Kryetar**

dhe

### **Caritas Kosova**

Përfaqësuar nga: **Alfred Pjetri - Drejtor Ekzekutiv**



**Shkurt 2021**



## **Neni 1 Qëllimi**

1.1 Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MiM) është: Ofrimi i shërbimeve të përbashkëta në interes të përgatitjes dhe këshillimit të të rinjve të Komunës për tregun e punës në kuadër të projektit PRAXIS.

## **Neni 2 Përgjegjësitë dhe obligimet e Komunës së Gjakovës**

2.1 Komuna do të ofrojë mbështetje profesionale, përmes resurseve njerëzore (zyrtarëve komunal) në mbështetje të realizimit të qëllimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij MiM.

2.2 Komuna do të ofrojë mbështetje logjistike-infrastrukturore, për organizimin e aktiviteteve të parapara në projekte të ndryshme, të cilat mundësojnë përgatitjen profesionale për të rinj.

2.3 Komuna do të angazhohet në rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimin edhe me institucione dhe organizata të tjera relevante, përvoja e të cilave mund t'i shërbejë Caritas-it, në implementimin e suksesshëm të projektit që mbështesin të rinjtë.

2.4 Komuna, përmes drejtorive përkatëse, si: Drejtoria e Arsimit, Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport, dhe drejtorive të tjera, do të mundësojë qasjen në shkollat dhe institucionet tjera, ku të rinjtë do informohen për shërbimet që ofron Caritas Kosova në përgatitjen e të rinjve për tregun e punës.

2.5 Komuna do të promovojë projektet dhe mundësitë e ofruara nga Caritas Kosova për të rinjtë në hapësirat zyrtare të komunikimit dhe informimit, si web, facebook page, etj.

## **Neni 3 Përgjegjësitë dhe obligimet e Caritas Kosova**

3.1 Caritas Kosova, do të ofrojë stafin e vet të cilët do të punojnë drejtpërdrejtë me të rinjtë e Komunës, në evidentimin e nevojave të të rinjve për përgatitjen për tregun e punës.

3.2 Caritas Kosova do të mbështesë të rinjtë e Komunës nga mosha 14 deri në moshën 29 vjeçare, përmes ofrimit të shërbimeve konsultative dhe përgatitjen profesionale të tyre për nevojat e tregut të punës përmes ofrimit të trajnimeve profesionale dhe akademike.

3.3 Caritas Kosova do të angazhohet në bashkëpunim të ngushtë me bizneset e Komunës për tu siguruar për nevojat e bizneseve për kualifikimet e nevojshme profesionale që kërkohen në tregun e punës. Bazuar në këtë analizë, Caritas Kosova do të ju ofrojë të rinjve mundësi për punë praktike në bizneset e Komunës.

3.4 Të gjitha raportet e realizuara dhe hulumtimet e bëra nga Caritas Kosova, do t'i jepen në shfrytëzim Komunës, për të ndërtuar politika dhe plane zhvillimore që mbështesin përgatitjen profesionale të të rinjve për punësim.



#### **Neni 4 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

4.1 Mosmarrëveshjet e krijuara nga ky MiM palët duhet t'i zgjidhin përmes bisedimeve.

#### **Neni 5 Përfundimi**

5.1 Palët mbajnë të drejtën për të anuluar këtë MiM në rast të moszbatimit të kësaj marrëveshje sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në marrëveshjen e bashkëpunimit.

#### **Neni 6 Kohëzgjatja**

6.1 Kjo marrëveshje është e lidhur për afat dyvjeçarë, nga dita e nënshkrimit, por mund të ju shërbej palëve edhe më gjatë, nëse ka pajtueshmëri të dy anshme të shprehur nga palët.

#### **Neni 7 Hyrja në fuqi**

7.1 Ky MiM hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dy palët nënshkruese.

**Komuna e Gjakovës**

  
z. Ardian Gjini  
Kryetar



**Caritas Kosova**

  
z. Alfred Pjetri  
Drejtor Ekzekutiv



Gjakovë

Më: 16.02.2021